Kronikë

Lezhë/ 45-vjeçari shkon në spital me plumb në këmbë, dërgohet te Trauma! Ja çfarë dyshohet (EMRI)

Një 45-vjeçar është paraqitur i plagosur me armë zjarri në urgjencën e Spitalit Rajonal të Lezhës. Rasti është regjistruar pak pas mesnate, ndërsa i dëmtuari është shtetasi Mond Gjoka banues në fshatin Raboshtë.

Foto ilustruese

Elvis Hila
2 Dhjetor, 08:12 | **Përditësimi: 2 Dhjetor, 09:33**

Share

Një 45-vjeçar është paraqitur i plagosur me armë zjarri në urgjencën e Spitalit Rajonal të Lezhës. Rasti është regjistruar pak pas mesnate, ndërsa i dëmtuari është shtetasi Mond Gjoka banues në fshatin Raboshtë.

Ai ka marrë një plagë në këmbës dhe pasi mori ndihmën e parë mjekësore në urgjencën e Lezhës është dërguar në Spitalin e Traumës në Tiranë, për ndihmë më të specializuar mjekësore nga ku bëhet e ditur se ndodhet nën kujdesin e bluzave të bardha jashtë rrezikut për jetën.

> *"Ne spitalin e Lezhës është paraqitur për ndihmë mjekësore shtetasi M. Gj., 45 vjeç, banues në Rraboshtë, Lezhë. Nga hetimet paraprak dyshohet se shtetasi M. Gj., është vetëplagosur me armë zjarri, në këmbë dhe ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Grupi hetimor po punon për sqarimin e plotë të rrethanave dhe shkakut si dhe për dokumentimin ligjor të rastit", njofton policia.*

[Sh.com]
LEXO EDHE:
Lejuan ndërtime pa leje në zonën e mbrojtur të Patokut, prokuroria e Lezhës çon në gjykatë dosjen për ish drejtorin e IMT-së Kurbin, ish kryeinspektorin e IKMT-së e 6 të tjerë

Ndërkohë, policia e cila nisi hetimet në lidhje me rastin bën më dije se nga veprimet paraprake dyshohet se 45-vjeçari Mond Gjoka është vetëplagosur me armë zjarri pranë një lokali në fshatin Gryk Zezë të Lezhës.

Por, grupi hetimor po punon për sqarimin e plotë të rrethanave dhe shkakut si dhe për dokumentimin ligjor të këtij rasti, për të parë nëse ka patur ndonjë konflikt mes personave të tjerë dhe 45-vjeçarit i cili paraprakisht nuk rezulton të jetë person me precedent të mëparshëm penal.

S.G/Sl.E./Shqiptarja.com

TAG: Mond Gjoka | Lezhë | gryke zeze

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

[Sh.com]
Sondazhi i ditës:
2 Dhjetor, 11:38
Buxheti 2025, a duhet pranuar amendamenti i PD-së për minimumin jetik?
Po | Jo | Nuk e di

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Lajme të tjera

Aksident në aksin Lezhë-Shkodër/ Makinat përplasen me njëra tjetrën, plagosen drejtuesit e automjeteve
1 Dhjetor, 17:39

Kampi i Gjadrit i boshatisur nga emigrantët, protesta e 'vonuar' e aktivistëve: Marrëveshje ilegale! Nuk është Europa e Ramës dhe Melonit (VIDEO)
Elvis Hila
1 Dhjetor, 12:55

Zhvillohet kampionati i mundjes në Lezhë, pjesëmarrës 14 ekipe nga i gjithë vendi! Fituesit do përfaqësojnë Shqipërinë në garat ndërkombëtare
Elvis Hila
1 Dhjetor, 10:54

Aksident në aksin Lezhë-Laç, një prej mjeteve shpërthen në flakë! Plagosen dy drejtuesit (VIDEO)
1 Dhjetor, 09:54

Prezantohet skema e re e stacioneve te plazhit, 83% e plazhit të Lezhës do të jetë publik, Ndreu: Rëra do të shfrytëzohet vetëm nga hoteleritë
Elvis Hila
30 Nëntor, 22:57

Kurbin/ Zjarri në fabrikën e këpucëve në Shullaz, shkak dyshohet të jetë një shkëndijë elektrike
30 Nëntor, 11:34

Lezhë/ Zjarr në fabrikën e këpucëve në Kurbin, vihet nën kontroll pas 4 orësh, digjet magazina e vajrave (VIDEO)
Elvis Hila
29 Nëntor, 22:04

29 Nëntori/ Homazhe në varrezat e dëshmorëve në qytete! Në Shkodër idhtarët e Komunizmit vendosin yllin, kujtojnë Enver Hoxhën
29 Nëntor, 11:21

Murtaja afrikane e derrit, identifikohet një vatër në Lezhë! Vendoset në karantinë zona në Malin e Rrenxit në Shëngjin
Elvis Hila
29 Nëntor, 09:49

VIDEOLAJM/ Lezhë/ Nënkalimi në Fushë Mamurras i pakalueshëm për makinat e vogla, niveli i ujit arrin 40 cm
29 Nëntor, 08:40

112 vite Pavarësi, flamujt kuqezi valëviten kudo, festime në të gjithë Shqipërinë
28 Nëntor, 12:18

Siguria në shkolla, a po përdoren fëmijët nga Qeveria dhe Opozita?
27 Nëntor, 16:37

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje